



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2400/1 Prot.

Tiranë, më 09.10.2025

VENDIM

Nr. 295 , Datë 1.10.2025

**“PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT TË STATUSIT TË MAGJISTRATIT PËR
PROKURORIN THOMA JANO”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 1.10.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për prokurorin Thoma Jano”



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2400 prot., datë 24.09.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi Relatorin, z. Zeqir Hoda, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim Këshilli*), ndër të tjera, garanton statusin karrierën e prokurorëve si pjesë e statusit të magjistratit të njohur nga ligji.
2. Nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë Këshillit është dërguar informacioni se, magjistrati Thoma Jano, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, i datëlindjes 01.10.1955, mbush moshën 70 vjeç në datën 01.10.2025.
3. Prokurori Thoma Jano është emëruar në këtë detyrë në datë 03.09.1993 dhe që prej datës 15.10.2002, ai ushtron këtë funksion në Prokurorinë e Përgjithshme.
4. Bazuar në nenin 65, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me Vendimin nr. 78, datë 22.04.2022, "Për pranimin e kërkesës dhe miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit z. Thoma Jano", Këshilli ka pranuar kërkesën dhe ka miratuar qëndrimin në detyrë të magjistratit Thoma Jano deri në mbushjen e moshës 70 vjeç.
5. Në nenin 64, pikat 1 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se:

"1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur:

c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji;

....

5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës."

6. Në këto kushte, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit i propozoi Këshillit, të deklarojë me vendim mbarimin e statusit të magjistratit për z. Thoma Jano, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, për shkak të mbushjes së moshës për pensionin e pleqërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenin 64, pikat 1 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, 189, pika 1, germa “a” dhe 192, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për prokurorin Thoma Jano.
2. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm dhe prokurori Thoma Jano.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e njoftimit të vendimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot më 1.10.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR

Erind Gërmenji

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Arta Mandro

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR

Vatë Staka

ANËTAR

Olger Eminaj

ANËTAR

Erind Merkuri

ANËTAR

Erion Fejzulla